

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 171/2014 “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT

Projektligji është propozuar si pjesë e paketës për ndryshime ligjore në legjislacion në fuqi që trajton procedurat e kalimit të tokës bujqësore të ish- ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve. Qëllimi i këtij projektligji është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual të cilat kanë krijuar problematika në zbatimin e tij.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Edhe pse legjislacioni për ndarjen e tokës bujqësore, dhënien e saj në përdorim e, më pas, kalimin në pronësi është rishikuar në vazhdimësi, procesi në përgjithësi është shoqëruar me mangësi e probleme të ndryshme. Nga informacionet e strukturave përgjegjëse për këtë proces si dhe nga ankesat e shumta të qytetarëve ka rezultuar se:

- Shumë familje bujqësore apo pjestarë të këtyre familjeve, të cilët kanë përfituar tokë në përdorim sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, nuk mund të pajisen me aktin e marrjes në pronësi të tokës për shkak të kufizimeve të vendosura në legjislacion për mos ndryshimin e vendbanimit.
- Për shkak të vonesave për transferimin e dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion, shumë familje bujqësore pavarësisht se kanë qenë banor *de facto* të njërive vendore të ish- ndërmarrjeve bujqësore nuk mund të pajisen me aktin e marrjes së tokës në pronësi.
- Komisionet e tokës në fshat, në shumë raste, nuk kanë plotësuar të plotë dhe të saktë dokumentacionin për përfitimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) për të gjitha familjet bujqësore, pavarësisht se këto familje i plotësonin kriteret ligjore për të qenë përfitues.

Moszbatueshmëria e ligjeve dhe akteve nënligjore ka ardhur jo vetëm nga mos angazhimi i njësive të qeverisjes vendore përgjegjëse për këtë proces por edhe nga vështirësitë që paraqet zbatimi praktik i legjislacionit.

Fenomeni është kombëtar, por për efekt ilustrimi po ju sjellim më poshtë shembullin e Bashkisë Divjakë:

- A.** Toka të cilat si rezultat i zbatimit të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar i janë dhënë në pronësi familjeve bujqësore që plotësojnë kriteret ligjore. Kjo kategori përbën pjesën më të madhe të përfituesve, dhe ndahet si më poshtë:

Nr	Fshati.	Siperf.ndare gjithesej Ha.	Nga Kjo		Familje Përfituese		Frymë Përfitues	
			Pronesi Ha.	Perdorim Ha.	Pronesi	Perdorim	Pronesi	Perdorim
1	Terbuf	1956	1688.34	267.66	877	296	4823	765
2	Shenepremte	549	496.44	52.56	292	44	1418	150
3	Grabjan	1728.57	1291.60	436.97	669	492	3690	1248
4	Ferras	638.87	518	165.87	231	116	1480	474
5	Karavasta e Re	860	500	360	199	145	860	720
6	Shuma	5732.44	4494.38	1283.06	2268	1093	6030	3357

- B.** Toka bujqësore të cilat i janë dhënë në përdorim familjeve bujqësore që përmbushin kriteret ligjore. Në këtë kategori përfshihen:

- Përfitues të cilët i përmbushin kriteret ligjore për ta përfituar kalimin e tokës në pronësi, por për arsye mos interesimi apo mos funksionimi të strukturave shtetërore kompetente, nuk janë pajisur me aktin e marrjes në pronësi të tokës. Në këtë kategori përfshihen dhe familjet të cilat janë të vendosura në këto territore me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.
- Përfitues të cilët e kanë përfituar aktin e marrjes së tokës në përdorim si rezultat i vendosjes në këto zona sipas përcaktimit të dispozitave të VKM nr. 306 datë 30.06.1994 si dhe VKM nr. 590 datë 13.10.1993.

Nr	Fshati.	Nr. Familjeve para dt. 01/08/1991		Nr. Familje me VKM.nr.306 dt.30.06.1994		Nr.familjeve me VKM.nr. 590 dt.13.10.1993	
		Nr. Fami	Ha. gjithesej	Nr. Familje	Ha. gjithesej	Nr.familje	Ha. gjithesej
1	Tërbuf	5	7	-	-	-	-
2	Shenepremte	-	-	-	-	-	-
3	Grabjan	10	16.80	70 Stravec	100		11.40
4	Ferras	-	-	-		88	704
5	Karavasta e Re	-	-	-	-	-	-
6	Shuma	15	23.80	70	100	88	715.4

- C.** Toka bujqësore të cilat i janë dhënë në përdorim familjeve bujqësore që nuk përmbushin kriteret ligjore. Në këtë kategori përfshihen:

- i. Përfitues të cilët e kanë marrë aktin e marrjes së tokës në përdorim pa i përmbushur kriteret e ligjit nr. 171/2014, neni 2, pika 1, shkronja a), nënshkronja i). Këto familje fizikisht kanë ardhur në fshatrat e Bashkisë Divjakë, pa u ndryshuar sistemi, kanë punuar në ish- ndërmarrjet bujqësore, kanë qënë *de facto* banor të njësisë vendore, por dokumentacioni zyrtar i gjendjes civile u ka ardhur me vonesë, duke mos plotësuar kriteret ligjore për vendbanimin brenda datës 01.08.1991.
- ii. Përfitues të cilët e kanë përfitur aktin e marrjes së tokës në përdorim duke i përmbushur kriteret e ligjit nr. 171/2014 , neni 2, pika 1, shkronja a), nënshkronja i), përsa i takon datës së vendbanimit, por që për arsye të ndryshme kanë ndryshuar vendbanimin e tyre dhe sot nuk mund ta përfitojnë pronësinë mbi tokën. Aktualisht nga kërkesat e depozituara në Bashkinë Divjakë rezultojnë 51 familje bujqësore, të cilat kanë ndryshuar vendbanimin e tyre.

Nr	Fshati.	Nr. Familjeve dt. 01/08/1991 të cilët kanë ndryshuar vend banim		Nr. Familje pas dt. 01/08/1991	
		Nr. Familjeve	Ha. gjithësej	Nr. Familjeve	Ha. gjithësej
1	Tërbuf			291	267.66
2	Shenepremte			44	52.56
3	Grabjan	30	42.00	465	436.97
4	Ferras	21	29.40	116	165.87
5	Karavasta e Re	1	1.16	144	360
6	Shuma	52	72.56	1060	1283.06

Vonesat e procesit dëmtojnë të gjithë familjet dhe individët, që ndonëse e përdorin faktikisht tokën bujqësore, nuk disponojnë dokumentacionin ligjor të pronësisë mbi të, çka pengon në formalizimin e tyre, përfitimin e subvencioneve nga buxheti i shtetit, kryerjen e transaksioneve, shpronësimet për interes publik etj.

Me miratimin e këtij projektligji do të bëhet e mundur zgjidhja e problemeve të mbartura në vite, në lidhje me plotësimin e dokumentacionit ligjor, në territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Për këtë projektligj është përdorur si referencë neni 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 3 nene, të cilat propozojnë ndryshimet në nenin 2 dhe nenin 6 të ligjit. Konkretisht dispozitat e projektligjit parashikojnë:

- Heqjen e kufizimit përsa i takon kritereve që duhet të përmbushin familjet bujqësore ose individët për mos ndryshimin e vendbanimit të tyre prej datës 1.10.1992. Ky ndryshim do shërbejë për zgjidhjen e problematikave të përmendura më lart siç ishin dhe vonesat gjatë transferimit të dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion.
- Reformulimin e nënshkronjës iii), të pikës 1, të nenit 2, të ligjit duke krijuar mundësi për të gjithë familjet bujqësore të cilat disponojnë aktin e marrjes në përdorim për të përfituar aktin e marrjes së tokës në pronësi pavarësisht përcaktimeve përjashtuese të bëra në VKM nr.452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar. Familjet bujqësore që përdorin tokën do ta përfitojnë aktin e marrjes në pronësi vetëm mbasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit.
- Shtimin e dy pikave të tjera të cilat propozojnë që të jenë subjekt i ligjit familjet bujqësore të cilat nuk e disponojnë aktin e marrjes në përdorim të tokës vetëm mbasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit si dhe familjet bujqësore të cilat e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim, por këtë akt e kanë përfituar mbas datës 31.12.1993, për këto të fundit toka do të mbetet në përdorim.
- Zgjatjen e afatit të përfundimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore nga data 31 dhjetor 2018, i parashikuar me ligjin 102/2017 në 30 qershor 2019.

Miratimi i këtij projektligji do kërkojë angazhimin e Këshillit të Ministrave për të ndryshuar aktet nënligjore në fuqi përsa i takon kufizimeve që lidhen me mosndryshimin e vendbanimi. Kështu konkretisht mbas miratimit të këtij projektligji do të duhet të ndërhyhet në VKM nr. 337, datë 22.04.2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” në dispozitat e mëposhtme:

- Pika 2, rishikimi i nocionit të “përdoruesit faktik të tokës bujqësore” në përputhje me ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshëmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar;
- Pika 2, shkronja c, për rishikimin e nocionit të mos ndryshimit të vendbanimit që prej datës 1.10.1992;
- Pikat 7, 8, 9 dhe 10, përsa i takon përjashtimit nga procesi të kryesive të fshatrave. Përfshirja e këtyre strukturave ka ndikuar në zgjatjen e pajustificuar të procesit si rrjedhojë e mungesës së logjistikës së nevojshme për të bërë afishimet të listës së përdoruesve si dhe në mbajtjen e korrespondencës më bashkinë.

Gjithashtu, kërkohen rishikime ligjore për angazhimin e të gjitha njësive të qeverisjes vendore me qëllim finalizimin e procesit brenda datës 30 qershor 2019.

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë bashkitë, këshillat e qarqeve, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë e bujqësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe prefektët e çdo qarku.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, si dhe është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit në fuqi.